

Çfarë është komisioni për raste të rënda?

Komisioni i Saksonisë së Ulët për raste të rënda është një grup specialistësh, i emëruar nga Ministria e Brëndshme me persona të jetës publike (ndër të tjerë nga kishat, komunat, shoqatat, ekonomia dhe mjekësia). Ai është përgjegjës për kërkesat e rasteve të rënda të qytetareve dhe qytetarëve të huaj, të cilët jetojnë në Saksoninë e Ulët.

Komisioni i rasteve të rënda shqyrton arsyet e posaçme individuale të rastit të rëndë, të cilat i qëndrojnë kundrejt përfundimit të qëndrimit.

Nëse komisioni aprovon një kërkesë të një rasti të rëndë, atëherë ai i drejton një lutje për rast të rëndë ministrit të brëndshëm. Ministri i brëndshëm vendos më pas mbi dhënien e një leje-qëndrimi për arsye të një rasti të rëndë (§ 23 a i ligjit për qëndrimin).

Kush mund të bëjë një kërkesë për një rast të rëndë?

Qytetaret dhe qytetarët e huaj të detyruar për largim nga vendi, të cilët duhet të lënë vendin apo të ekstradohen, mund t'i bëjnë kërkesë komisionit të rasteve të rënda, nëse largimi ose ekstradimi i tyre kundërshtohet nga arsyet urgjente personale apo humanitare.

Kur mund të paraqiten arsye për një rast të rëndë?

Një peshë të posaçme në shqyrtimin e arsyeve të rastit të rëndë kanë integriteti social, shkollor dhe profesional i personit, përkatësisht të familjes, të detyruar për të lënë vendin, si edhe rrënjësia e tyre në shoqërinë e këtushme.

Për këtë arsye të dhënat e mëposhtme janë veçanërisht të rëndësishme, si p.sh.:

- Kohëzgjatja e qëndrimit
- Frekuentimi i kopshtit dhe shkollës nga fëmijët.
- Arsimimi dhe kualifikimi i mëtejshëm profesional
- Marrëdhënia e punës
- Aktivitetet në fqinjësi dhe Shoqata, angazhimet vullnetare
- Lidhjet me marrëdhënie sociale dhe familiare
- Njohuri të gjuhës gjermane

Në mbështetje të kërkesës mund të dorëzohen edhe pozicionimet apo letra mbështetëse si p.sh. nga shkollat, shoqatat, fqinjët dhe punëdhënësit.

Jo shqyrtim i pengesave për ekstradim në vendin e origjinës

Komisioni për raste të rënda nuk është përgjegjës për shqyrtimin e problemeve dhe rreziqeve të mundshme në vendin e origjinës. Kjo është detyra e Zyrës Federale për Migracion dhe Refugjatët dhe e Gjykatave Administrative.

Proçedura me shkrim

E gjithë proçedura e rasteve të rënda zhvillohet vetëm me shkrim. Për këtë arsye duhet që të gjitha arsyet të paraqiten në mënyrë të plotë, individuale dhe të qarta.

Të autorizuarët mund të ndihmojnë

Qytetaret dhe qytetarët e huaj të preku mund të autorizojnë persona të besuar me bërjen e kërkesës për raste të rënda. Nuk është e thënë që të autorizuarët të jenë avokate apo avokatë. Ata mund të jenë qendra konsultimi, miq dhe persona të tjerë të besuar që mund t'i drejtojnë një kërkesë komisionit të rasteve të rënda.

Kur nuk është e mundur një kërkesë për një rast të rëndë?

Sipas § 5 të urdhërësës mbi komisionin e rasteve të rënda të Saksonisë

së Ulët (NHärtekVO) një kërkesë ndër të tjera nuk pranohet për këshillim, nëse

- qytetarja e huaj ose qytetari i huaj nuk ndodhet në territorin federal ose që vendqëndrimi i saj/i tij nuk është i njohur,

- qytetarja e huaj, qytetari i huaj nuk qëndron në territorin federal të paktën 18 muaj,

- ekzistojnë vepra të shumta penale, të cilat nuk kanë shumë vite që kanë ndodhur

- është caktuar dita për dëbim, apo që tashmë ka skaduar afati ekzistues. Arsyet konkrete për mospranim do t'i gjeni në § 5 NHärtekVO.

Ku mund të drejtohet kërkesë për rastin e rëndë?

Kërkesa e një rasti të rëndë mund t'i drejtohet një anëtar të komisionit për rastin e rëndë ose zyrës pranë Ministrisë së Brëndshme të Saksonisë së Ulët.

Adresat e anëtarëve mund t'i gjeni në www.hfk.niedersachsen.de

Veç kësaj nga kjo faqe interneti mund të shkarkoni edhe udhëzimin mbi komisionin për raste të rënda, si edhe formularët dhe ndihmesat e punës për kërkesë.

Informacione të mëtejshme mund të merrni në

**Geschäftsstelle der Härtefallkommission
beim Nds. Ministerium für Inneres und
Sport**

**(Zyra e Komisionit për raste të rënda,
pranë Ministrisë së Brëndshme dhe Sportit të Saksonisë së Ulët)**

**Lavesallee 6
30169 Hannover.**

Është e rekomandueshme, që përpara dorëzimit të një kërkesë të informoheni gjerësisht dhe gjithashtu të këshilloheni personalisht në zyrën përkatëse për qytetarët e huaj dhe/ose në një zyrë këshillimi emigracioni.

ju informon lidhur me

Udhëzimin për kërkesën për një rast të rëndë drejtuar komisionit për raste të rënda të Saksonisë së Ulët



Niedersachsen

Zyra e Komisionit për raste të rënda pranë Ministrisë së Brëndshme dhe Sportit të Saksonisë së Ulët